



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primiljavo Me/Dana 04-04-2022			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetësi Prilog	Vlera Vrednosit
01-110/05-369			



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, neni 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 31.03.2022, merr këtë:

## V E N D I M

për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së dytë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 28.02.2020

### Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për procesverbalin e mbledhjes së dytë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 28.02.2022.

### Neni 2

Pjesë e këtij vendimi është procesverbali i datës 28.02.2022.

### Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I  
Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË DYTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 28.02.2022 (e Hëne) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: Sokol Shaqiri, Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Ekrem Ymeri, Arbnore Hajredini, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Zejnepe Osmani, Ali Bajrami, Taibe Ibrahimimi, Jakup Demiri, Liridona Bislimi, Sejdi Emini, Nexhat Halili, Majlinda Shabani, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Lindita Demelezi, Taulant Haxhiu, Musli Neziri, Veton Ramadani, Vilsona Maliqi-Salihu, Zyrafete Rama, Anisë Zejnullahu, ndërsa mungoj Reshat Azizi.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dytë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, nënkryetar, këshilltar, përfaqësues të mediave, përfaqësues nga OSBE-ja, mirë se keni ardhur në seancën e dytë të rregullt. Materialin e keni marr me kohë dhe jemi përgatit për këtë seancë. Fillimisht e kemi deklarimin jashtë rendit të ditës. Kërkoj të respektohet koha e gjuha e komunikimit. Hapim diskutimin jashtë rendit të ditës.

**z.Ali Bajrami:** Kryesues, faleminderit për fjalën e dhënë. Kam një pyetje për ju kryesues. Vendimet e seancës së kaluar që i kemi votu a janë kthyer të ligjshëm.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Po të gjithë vendimet janë kthyer nga MAPL-ja dhe janë të ligjshëm.

**z.Ali Bajrami:** Kam një pyetje për drejtorin e urbanizimit. Drejtor, si dokument shumë i rëndësishëm për komunën është plani zhvillimor komunal. Çka keni bërë dhe çka jenu tu punu në këtë drejtim sa i përket rumbullaksimit të këtij dokumenti shumë të rëndësishëm që të sjellët për votim në kuvend.

**z.Ilir Zuka:** Përsëritje të nderuar të pranishëm! Kam disa pyetje. Një për drejtorin e kulturës, Valmir Sahitin. Drejtor, janë mbajtur lauratët e vitit 2021, besoni a po jo, për herë të parë në histori të Komunës së Vitisë nuk janë thirrur dy klubet në zgjedhjen e laureatit KF “Vllaznia”, e cila feston 50 vjetorin e themelimit vitin e ardhshëm. Nuk është ftuar edhe klubi “Vitia”. Janë dy klubet që përfaqësojnë ligen e parë e një kohë “Vllaznia” e Pozharanit ka qenë në Super Ligën e Kosovës, e këto nuk janë ftuar në zgjedhjen e laureatëve, e keni bërë zgjedhjen e laureatëve me shkollë të futbollit. Kerkun kjo nuk ndodh, ato shkollë janë përfituese të komunës, ato nuk keni nevojë me të zgjedh me të mirët, po duhet ato që kontribuojnë për komunën. Ju kisha lut me ju kërku falje dy klubeve për këtë. Dhe pyetjen e dytë e kam për nënkryetarin. Është mirë me dal me ju shpjegu qytetarëve të Pozharanit dhe pesë fshatrave, a është i pijshëm uji që ekziston në Pozharan, sepse sipas do informatave që i kemi marr ne, ka sasi të madhe të mangamit dhe nuk është i lejuar për pije.

**z.Basri Sylejmani:** Për drejtorin Basrinë, çështja e ujit në Sadovinë, Trestenik, Sllatinë. Kemi bisedu më herët me drejtorinë për çështjen e ujit. Po tani uji i jonë nuk është as nuk ka ujë, se çka është puna nuk po e di. Edhe këtu taksistët, është hera e dytë që e ngris këtë çështje, duhet me marr një vendim me ju bë një zgjidhje për taksistët.

**znj.Liridona Bislimi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kam pa disa konkurse që janë shpall në ëeb të Komunës së Vitisë dhe kam një vërejtje për njërin nga konkurset që është specialist për përkthim dhe interpretim. Vërejtja ime është tek faqja e dytë këtu në konkurs, pika e katër, kërkesa, njohuritë e përgjithshme tek arsimimi i kërkuar, kualifikimet e përshtatshme baçelor ekonomik, juridik, administratë publike. Pra, personi në fjalë që kërkohet ka për të bërë përkthime në Gjuhën Shqipe, në Gjuhen Serbe dhe anasjelltas. Mendoj që tek kualifikimet duhet të ishte kërkesa për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi e jo ekonomi. Pse ka dal kështu, kërkoj që konkursi të anulohet dhe të përpilohet përsëri. Nxënësit e fshatrave Kolishtë, Letnicë nuk mujnë të bëjnë udhëtime për shkak të pagesës së transportit dhe për shkak të kushteve jo të mira ekonomike, e ata po e ndërprejnë shkollimin. Këtë kërkesë po ja drejtoj qeverisë, që është thuaja që një dekadë dhe ende nuk ka zgjidhje për këtë problem. Kam vizituar tregun e gjelbër në Komunën e Vitisë dhe sinqerisht gjendja momentale e kushteve esenciale është e mjerueshme. Mund të themë me plotë bindjen e fjalëve që jemi një ndër komunat me gjendjen e tregut të gjelbër më jocilësor. Ne e dimë që ekziston një kontratë e mëhershme për përpunimin e tregut të gjelbër. Tregtarët nuk kanë kushte esenciale, nuk kanë ujë të pijshëm, nuk ka kanalizim, nuk ka as VC. Edhe tjetra, besoj që e keni pa në televizion, që është shpërnda një deponi e mbeturinave në fshatin Drobesh. Kisha pas dëshirë të di se, nëse Drejtoria e Shërbimeve Publike është duke u merr me këtë çështje duke e trajtuar që të bënë ndonjë zgjidhje, sepse banorët janë aty në gjendje të keqe. Kryesues, në mbledhje të KPF-së unë kam pas disa kërkesa, e kam prit që të merren parasysht. Unë kam kërkuar që të vjen një raport nga psikologu i komunës, kam kërku të kemi informacione rreth inventarizimit të komunës etj. Deri më tani nuk kam asnjë përgjigje për këto.

**znj.Majlinda Shabani:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam pyetje për drejtorin e inspeksionit, z.Adnan Ymeri. Në muajin Janar është informua për një problem sa i përket kompanisë së udhëtimeve. Besoj që drejtori e din për çka është fjala. Dua të di nga ai a janë ndërmarr hapa, sepse kemi ankesa. Është fjala për fshatin Trestenik.

**z.Taulant Haxhiu:** Të nderuar të pranishëm! Unë në fillim i kamë disa shqetësime, pasi që vij nga qytetit i Vitisë e ku vetëm në qytetin e Vitisë në dy shkollat fillore “Bafti Haxhiu” dhe “Dëshmoret e Kombit” nuk kemi fusha të futbollit të gomës, kurse në fshatrat e tjerë që kanë edhe nxënës më pak kemi fusha. E pse në qytet të Vitisë nuk kemi fusha të gomës? Tjetra, i nderuari Basri Aliu, vendimi për taksista. Kemi dikun 20 taksista në qendër të Vitisë. Ata sot nuk kanë ku t’i parkojnë veturat e tyre, ata mbajnë familje. A mund të ja bëjmë një zgjidhje atyre, që vetuar private mos ti lamë aty po ata ta kanë vetëm vendin e vet aty. Kërkoj nga drejtori që shumë shpejtë të merr një vendim për ta. Pyetje për drejtorin e kulturës. Tash fillojmë muajin Mars dhe Flakadani i Karadakut është një ndër festat më të mëdhaja që i kushtohet dëshmorit “Njazi Azemi”. Viti 2020-2021 e kemi pas kohën e pandemisë dhe ky organizim ka qenë më i zbehtë. A keni planifiku me pas një organizim më të mirë këtë vit.

**znj.Zyrafete Rama:** Të nderuar të pranishëm! Kam pyetje për nënkryetarin. Në Pozharan kanë filluar dy projekte prej vite e që kanë mbetur në gjysmë. Bëhet fjalë për shkollën fillore “Halil Alidema” dhe stadiumi “Ibrahim Kurteshi”. A mund të na jepni një datë të saktë se, kur do të përfundojnë këto projekte. Pyetja tjetër. Kur do të fillon projekti i asfaltimit të rrugës në fshatin Mjak.

**z.Nexhat Halili:** Përshëndetje për të gjithë! Fillimisht me vjen mirë që, Basria e pranoj që ujë nuk ka. Unë edhe në seancën e kalume e kam cek që, uji mungon. Unë kam disa pyetje. Po ju drejtohem nënkryetarit po edhe drejtorit të shërbimeve publike. Çka është bë për ndërtimin e trotuarit, i cili i lidh tri fshatra: Sllatinën e Epërme, Sadovinë e Muhagjerve dhe Trestenikun. Unë e di që është lidh një kontratë me datën 27.10.2021: po

çka është marr në këtë drejtim? Pyetja tjetër është për ndriçim publik. Në fshatin Trestenik është bërë ndriçimi publik për dy lagje, po ka edhe pesë lagje tjera që nuk kanë ndriçim publik: Çka do të bëhet për këto lagje. Asfaltimi i rrugës në lagjen "Ali Muhagjeri" është asfaltu pjesa e parë, mirëpo pjesa tjetër ka mbetur pa asfalt. Ju bëj pyetje: kur do të asfaltohet kjo rrugë? Ka kosto të vogël. Edhe një pyetje për drejtorin e inspeksionit, për shenjat e komunikacionit. Unë ju përgëzoj për shenjat e komunikacionit në fshatin Sllatinë të Epërme, po çka është ndërmarr në Sllatinë të Ulët, Sadovinë të Muhagjerve, Trestenik nuk ka sheja të komunikacionit: kur do të vendosen këto shenja?

**z.Musli Neziri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Fillimisht kam një kërkesë për nënkryetarin. Meqenëse ishim për 14 vjetor të Pavarësisë së Kosovës në varrezat e dëshmorëve, në homazhe, e aty ishin edhe familjarët e tyre. Prandaj duhet të dimë se, sa janë përkrah këto kategori dhe çka është bërë për këto kategori, sepse ata kanë kërkesa të shumta. Me kërkesë të fshatit Tërpezë, meqenëse u ngrit çështja e ujit të pijes, edhe ai fshat nuk ka ujë të pijes, dikun 20% e fshatit ka ujë të pijes, të tjerët janë jashtë funksionimit të sistemi të ujësjellësit të fshatit në Tërpezë. Prandaj aty me një investim shumë të vogël të komunës do ta rikthen ujësjellësin, sepse pozitën gjeografike burimin e ujit e ka të sigurt. Prandaj edhe është uji i mirë për ta. Pyetja tjetër është, para pesë vite në vitin 2017 është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në mes Komunës së Gjilanit dhe të Vitisë për lidhjen e dy zonave komunale në mese fshatit Ballancë-Kravariçë, dhe që nga ai vit ende nuk është krye ajo. Mundësisht më na dhanë një sqarim, a do të kryet apo si do të jete puna e saj.

**z.Remzi Salihu:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kam disa pyetje. Nënkryetar, kur flasim për arsimin në Komunën e Vitisë, të gjithë e dimë se përpos të arriturave në këtë lëmi kemi edhe vështirësi dhe mangësi të ndryshme. Andaj, edhe nevojat për investime nuk janë të pakta. Si mangësi ose parregullsi kemi edhe numrin e madh të mësimitdhënësve, të cilët janë pranuar me kritere dhe pa kritere të rekomandimit nga Ministria e Arsimit, Shkencës. Kjo është pyetja: se çka keni menduar të merrni me këtë drejtim? Si qëndron puna me pajisjet nëpër objektet e shkollave, me pajisje, me aparate për fikjen e zjarrit, në sa shkolla ka aparate të tilla? Dhe nëse ka, a janë funksionale? Dhe nëse nuk ka, çfarë keni ndërmarr që të pajisen këto objekte me aparate? Nga një anë, çdo herë thirrni në unitet e në punë të përbashkëta, ndërsa në anën tjetër vendosni në fshehtësi çdo punë që e bëni. Fjala është, me sa kame dëgju korridoreve, marrëveshja me një organizatë IPO për rregullimin e objekti të shkollës së mesme "Kuvendi i Lezhës". Nëse është e vërtet, me vjen shumë mirë, se aty ka më së nevojë të domosdoshëm të bëhet një intervenim i tillë, po nëse është e vërtet, pse ne si kuvendar nuk njoftohemi apo shefat e grupeve parlamentare, po dëgjojmë rrugëve për kësi investime. Dhe në fund, e di që shumëkush nga ju thuan që, të gjitha që i thashë nga kjo foltore do të kisha mundësi me i thanë nga ulësja e këshilltarit, por çështja është se, nga kjo foltore jeni edhe ju në dijeni, jam akuzu se kam kërcënuar drejtorin e shkollës nga ku unë punoj. Besoj që mediat e kanë sqaruar këtë punë, po edhe për ju, pra ta dini se, kjo ka qenë absolutisht e pavërtetë, e kështu që, e kam thanë edhe atë ditë, e nga kjo foltore du të kërkoj nga kryetari që, të kërkon falje për shpifje ndaj meje. Përndryshe, ose do ta padisë ose tash e tutje do ta quaj shpifës. Pra, ja përcjellni këtë kërkesë.

**z.Sejdi Emini:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në rend të parë uroj shendet për te gjithë! Unë kam disa kërkesa të cilat janë në interes të përhershëm për qytetarët e Komunës së Vitisë. Më herët kam inicu që, Vitia të ketë një shkollë të muzikës. Prapë po insisto që, kjo të realizohet duke marr për bazë të gjitha parametrat dhe kushtet ekzistojnë që me e gëzu këtë të drejtë elementare, edhe talentët të cilët i kemi në komunën tonë. Këtë të drejtë e gëzon një komunë më e vogël se ne, siç është Kamenica. Mendoj që, duhet me ndjek modelin e formën që me ofru këtë shërbim edhe tek ne në Viti. Kur jemi tek ndriçimi publik, e kam thanë edhe më herët edhe po e përsërisë, është shumë me interes që të bëhet ndriçimi publik tek vendkalimet e këmbësorëve. Nëpër shumë komuna i kemi këto, sepse është siguri dhe qytetërim. E kam inicu shumë herë tregtuarin në fshatin Goshicë. Kam thanë se, ende aty nuk ka asnjë metër trotuar. Vazhdimisht qytetarët të cilët dalin të ecin e që pjesa gjeografike është shumë e mirë, vijnë edhe nga fshatrat tjera aty për me u shëtit,



rrzekohen nga veturat, mirëpo më herët u thanë që, procedurat kanë kalu, është në përfundim e sipër, dua ta di kur fillojnë këto procedura dhe kur mund ta kemi trotuarin në fshatin Goshicë. Unë dje kam qenë në Pozharan, kam keshyr lojën e futbollit edhe në Pozharan edhe në Sadovinë. Tek fushat është e domosdoshme me pas tribuna për ata shikues që dojnë me pa lojën.

**z.Durim Sylejmani:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Fillimisht do të doja të beja një reagim ndaj kryetarit, lidhur me seancën e kaluar. Në seancën e 31 Janarit të këtij viti, tek sa unë po dilja nga salla e kuvendit, kryetari Haliti, në tentim për të më ofenduar me ka quajtur fëmijë i dreqit. Unë do doja të ja bëja me dije kryetarit Haliti që, unë nuk jam fëmijë i dreqit, unë jam asamblist dhe jam përfaqësues i qytetarëve. Këtu nuk më ka sjell lejteku po vota e qytetarit. Unë jam djalë i dy prindërve. Nga e ka marr ai atë konstatim që, prindërit e mijë janë dreq. E ftoj që ta jep përgjigjen, mos t'i ik debatit dhe temave të kuvendit komunal. Mu më vjen keq për kryetarin Haliti, po më shumë për qytetarët e Komunës së Vitisë, se në çfarë gjendje dhe në çfarë niveli ka ra kryetari Haliti. Unë nuk jam ndje i ofenduar ndaj fjalisë, sepse personi që ofendon duhet të ketë dinjitet, prandaj nuk jam ndi i ofenduar, sepse kryetari Haliti nuk ka dinjitet. Unë e di që kritikën nuk ja banë edhe është mësu që, zërat kritik t'i blej të gjithë, mirëpo tash ka ra në opozitë të vërtet dhe duhet mu mësu me kritika, dhe e ftoj që të jet më shpesh prezent në seancat e kuvendit komunal.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Ju lus që të përmbahemi nga gjuha ofenduese.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje për të gjithë! Në mbledhjen e kaluar kisha një kërkesë që, kryetari të jet prezent, e ai u zotu që do të jet, po fatkeqësisht si çdo herë tjetër po mungon. Unë kam një kërkesë. Në mbledhje të KPF-së, drejtori i financave e ka pas një kërkesë që, me sjell listën për persona me shërbime të veçanta. Me datën 17.02.2022 ishte dita e Pavarësisë së Kosovës, e ne ëeb të komunës nuk janë publiku asnjë informatë për manifestimin, që ka qenë prezent edhe LVV-ja. Kjo është vërejtje. E njoftoj komunën që, ndriçimi në Smirë funksionon edhe ditën, duhet me këqyr këtë.

**z.Illir Zuka:** Komuna e Vitisë 2019, 2020, 2022 i ka ndërtu nja katër fusha të futbollit. E përgëzojmë për punën që e ka bë, dy fushat në Pozharan, Sadovinë, Viti. Po problemi është se, unë mendoj që aty urgjentisht duhet me qu nga një mirëmbajtës, sepse në gjendjen që është fusha, është gjynah nëse nuk ka mirëmbajtës. Kërkoj që të merren masa për këtë. Edhe një kërkesë tjetër për hirë të punëtorëve të komunës. Unë e di që, për nja tetë vite kemi pas probleme me parkingje. E lus drejtorin e administratës, me marr masa. Është mbrapa komunës një parking, në mëngjes aty mushet parkingu me punëtor të KEK-ut, edhe me punëtor tjerë, që nuk janë pjesë e komunës, ndërsa punëtorët e komunës kanë shumë probleme ku me e parku veturat.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në mbledhjen e KPF-së gjatë janë shtrua nja 15 pyetje, e ku drejtori i ka sjell me shkrim pyetjet. Njëashtu është kërku edhe nga drejtori i inspeksionit për trajtimin e qenve endacak dhe për këtë nuk kemi harru edhe i keni me shkrim të cilat po ju dorëzoj tani. Më lejoni të filloj ne pyetjet e juaja të parashtruara. Me arsye sot mungon kryetari i komunës edhe drejtoresha e arsimit, të cilët janë në takime në ministri. Sa i përket ujit të pijshëm, jam në kontinuitet me fshatrat të cilët momentalisht janë pa ujë dhe kemi pas takime, edhe do të kam takim nesër ne Gjilan me "Hidro Moravën" dhe CDI-në. Analizat të cilat i bënë para disa kohe, aty gjithherë po na del që kemi elemente të mangonit gjithherë të rritur dhe derisa të stabilizohet nuk guxon "Hidromorava" me e marr në menaxhim duhet me i plotësu të gjitha kushtet që ajo me marr në menaxhim. Lokaliteti i Sllatinës, Sadovinës së Qerkezve, Jerlive, sepse nja dy tre muaj, një muaj kemi participu edhe ne komuna dhe disa mjete i kanë grumbullu, e i kanë pagu shpenzimet e rrymës, e tash është një kosto e rrymës të cilën nuk e kanë pagu dhe është ndal rryma, sepse ujë ka po rryma u ndal. E për këtë ujë nuk ka. Këtë çështje e kam ngrit edhe me CDI-në në takim, një kërkesë, sepse është defekt i CDI-së që, nuk e ka pru në parametra të sakta, që me ja dhanë "Hidromoraves" dhe me fillu me u pagu rryma e qytetarët me pas ujë e për shkak të mungesave financiare që edhe ata e kane vitin fiskal. Ashtu më kane thanë. E për këtë kjo gjendje ka mbet deri sot kështu. Edhe për Pozharan ke një pyetje. Shumë herë e kanë bë këtë pyetje, edhe unë kam pyet shumë herë deri tek drejtoresha e entit higjienik

dhe e ka konfirmu pavarësisht asaj që nuk kontrollohet dhe është në konturat e ujit të pijshëm. Konkursët, duhet ta kemi të kuart se, çdo sektor është i specializuar për punën e vet të cilën e kryen. Obligimi i kryetarit dhe nënkryetarit është me ja dhanë si detyrë për vendet vakante me i qit, ndërsa sektori që është për atë çështje, në këtë rast udhëheqësi i personelit së bashku me stafin e vet i ka parasysh ligjet dhe udhëzimet administrative, i ka parasysh edhe përshkrimin e vendit të punës, dhe konsideroj që në përputhje me këtë e qet edhe konkursin. Po vazhdoj në vitin e 9-të si nënkryetar i Komunës së Vitisë. Le të del njëherë që ju kam perzi, pse e ke qit qashtu konkursin. Unë nuk përzihem në profesionalizëm, fatmirësisht as Sokol Haliti nuk përzihet. Kolisht-Letnicë i kemi marr nxënësit, e për këtë vit nuk po e disha këtë, e do të interesohem për këtë pyetje. Më vjen mirë që e ke vizitu tregun e gjelbër. U kanë mirë më shku me keshyr se, në menaxhim të kujt është. U dashtë me këqyr në pronën e kujt është dhe është dashtë me këqyr cilat janë kompetencat e komunës aty. Po të ishte tregu i gjelbër pronë komunale, po të ishte e menaxhuar nga ana e komunës, nuk ishin kalu këto vite pa u rregulluar ato. Nga mandati i parë kemi bë përpjekje maksimale, që ato prona me i kthy në prona komunale. Kur dush, Liridona me jep një afat dy tri ditë edhe t'i grumbulloj shkresat, se sa herë ju kame drejtu AKP-së e qeverisë, që me i kthy ato prona. E vizitën që e ka bë kryetari. Ata janë qytetar të Komunës së Vitisë. Në dy shkollat e Vitisë nuk kemi fusha të futbollit, është një realitet, e kemi pas në balt e i kemi kthy ne asfalt, dhe ju e dini që gjithherë kur bëhet shpërndarja e buxheti behet në çdo lokalitet, e besoj që edhe ato fusha janë në projekt, e besoj që e meritojnë e duhet të bëhen. Zyrafetja i ka bë dy pyetje për shkollën dhe stadiumin. Po të ishin investime tona këto, do te isha lidh me afat, po janë investime që bëhen nga ministria dhe nuk po e di kohën se kur do të përfundojnë. Edhe tek çështja e Mjakut. Naj ka ndalu tash ta shohim çka mujm me bo e kena pas projekte buxhet naj kane ndalu procedurat, janë investim te cilat vijnë nga ana e ministrisë, çka është bërë për trotuar për tri fshatrat. Unë besoj se deri kur janë procedurat, ndriçimi publike në çdo lagje. Ne kemi bërë ndriçime publike, ndoshta edhe me tepër e kemi ngarkuar me shpenzime edhe te rrymës, por megjithatë është në trend dhe besoj se kur në asnjë lokalitet nuk i ka hy përniher as ndriçimi dhe as trotuari, por gradualisht besoj qe po. Një ashtu edhe për rrugën "Ali Muhaxheri", qaq ka pas mjete, qaq është asfaltu dhe shkojmë në hapa të mëtutjeshme, për ato të cilat kanë mbet. Sa janë përkrah kategoritë e familjes së dëshmorëve nuk do t'i them se, ndoshta janë simbolik e ato të cilat i thojmë, por me gjithë atë shoqnia jonë dhe niveli qendror dhe ai lokal ka bo përpjekje me ato mundësit e veta, me gjithë atë kurr nuk bëhet boll për ato familje sa dush mu bo, por duhet te veprojmë në kuadër kapacitetëve tona dhe mundësive tona që i kemi. Respekti më i madh është mos t'i harrojmë kur ka ekzistu marrëveshja Ballancë Kravaricë, që e shtroj një prej këshilltarëve. Ka ekzistu një disponim në atë kohë për shkak se një zëvendës ministër nga ana e Gjilanit dhe ka pas premetu këtë çështje ne e kemi kryer punën tonë me zhavorë por megjithatë tash momentalisht kjo gjendje dhe sa kemi me mujt me shty dhe me i lidh ato dy lokalitete se me të vërtetë e shkurtojnë rrugën shumë, numëri i madhë i puntorëve të pranuar me kritere dhe pa kritere unë besojë te pa kritere nuk ka për shkak se është ajo pjesa e akeseve të cilët kanë të drejt mu anku se tash ka një anëshmëri në shkallën e parë ,shkalla e dytë besojë që e rregullon atë çështje dhe e kthenë në lënden në rishqyrtim apo anulon i ka të gjitha të drejtat dhe konsideroj se janë shkallshmerisht dhe është edhe ligji që ja garanton këtë çështje, si qëndron puna me aparate janë shërbimet publike që e ka kompetencë. Besojë qe e ka edhe për shkolla, jem tu bërë përpjekje maksimale por tash kur do t'i arrijmë dhe shkollës muzikës edhe teatrit në Komunën e Vitisë. Janë të dyat që i japin tiparet e një qyteti të komunës tonë. Kur do t'i arrijmë, besojë kërkohet të respektohen procedurat, kuadri për talent unë besojë që ka ndriçim në vendkalimin. Ne po bëjmë përpjekje dhe pse jo mos mi bëre edhe vendkalimet që konsiderojë që është shumë e mirë. Edhe për trotuarin Goshicë do të marr informacion e plotë dhe në mbledhjen e ardhshme. Dhe në fund do t'i kisha thënë vetëm dy fjali për shkak provojës sime, duhet të kursehem me fjali. Unë dëgjova dinjitet, pa dinjitet ne nuk jem peshore të kujt t'ia masim dijen kush aq sa din, kush as sa ka dinjitet, por nga ky fjalor unë konsideroj se duhet të kursehem maksimalisht, për shkak se tash përcjellmi edhe nga mjetet e informimit nuk është kulturë, nuk është traditë shqiptare me i thanë dikujt dhe në mesin e traditës

shqiptare. Ndoshta ne se kem mrrri kulturën, bilë traditën duhet ta ruajmë. Duhet të kursehemi, të dimë çka është i pari, cili është i dyti, cila është pozita e këshilltarit dhe me të vërtetë të kursehemi në këtë drejtim, krejt pyetjet të cilët jeni të interesum me i bërë. Ne jemi këtu, nuk do të pretojmë kur me i dhënë përgjigjet, ndoshta jo përgjigjet ashtu qysh e kërkoni ju, por përgjigjet ashtu qysh është gjendja. Nuk e kam dëgjuar atë që the ti, të betohna se nuk e kamë ndëgjju atë pyetje të cilën që the ma ka bërë. Ai nuk është këtu me plotë arsye dhe duhet të kursehemi nga ai fjalor këtu. Ma tepër po ju kërkoi për shkak se kem kalu sfida. Unë kam kalu shumë ma të vështira prej mas luftës, por e kem rujt si etik, duhet ta ruajmë për brezat edhe për të ritë si ti dhe më të ri se ti dhe me të vërtetë vazhdojmë së bashku, se nuk kamë hise më shumë as si ti në Viti po as më pak, as skam bërë më shumë se ti po as më pak edhe këtë duhet me pas ju. Në rast se kamë bërë ma shumë për shkak të viteve që kam, por e drejta jonë për me e shfrytëzu hapësirën në Viti, për me i shfrytëzu qytetarët e Vitisë, me i bisedu është e barabartë besojë për të gjithë.

**z. Visar Demiri, drejtor:** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Desha të informojë këshilltarin komunal, z. Ali Bajrami me pyetjen që e bëri për planin zhvillimor komunal. Plani zhvillimor komunal si dokumenti më i rëndësishëm i planifikimit në Komunën e Vitisë, tash pothuajse është në përfundim. Ministria veç ka kërkuar kompanisë, e cila është duke u marr me hartimin e planit për t'i plotësuar disa të dhëna, pastaj brenda javës besojë e kthejmë në ministri dhe merr pëlqimin. Pas debatit publik kthehet prap në ministri dhe prej aty vjen në kuvendin komunal për miratim. Jemi në përfundim të kësaj procedure dhe pastaj do të vazhdojmë me hartat zonale të cilat fatmirësisht kem punu paralelisht me planin zhvillimor komunal, që mos të vonohemi në kohë edhe me hartat zonale

**z. Basri Aliu:** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë drejtorët dhe të gjithë asamblistët të cilët janë prezent këtu dhe për mediat e shkruara dhe elektronike që janë sot dhe po na përcjellin! U bërën disa pyetje drejtim të shërbime publike më vjen mirë që jeni të interesum këtë drejtim që ti dalim në ndihmë qytetarëve, por edhe neve të na përmirësoni këtë drejtim që ti evitojmë disa mangësi po edhe aty ku nuk kemi informacion të duhur të intervenojmë, atëherë unë po mundona edhe pse pjesërisht ju ka përgjigj edhe nënkryetari për mos mi përsërit, ndërsa për pyetjet tjera do të mundona të jap përgjigje dhe bashkëbisedojmë lidhje me pyetjet të cilat i kemi si shqetësim dhe interesim për qytetarët, për ujësjellësin në Tërstenik u përgjigj edhe nënkryetari po edhe unë isha në atë takim, kështu që kemi mbet të shofmi se çka mujm me bo në të ardhmen në këtë drejtim. U bo një pyetje edhe për taksistët, jemi tu mundu në këtë drejtim me bo një zgjidhje edhe pse tash për momentin është pak e vështirë. Vendim unë si drejtorat unë skam të drejt të marr acidentime që ti caktoj por do të mundohemi që së bashku me juve të gjithë kështu që ta caktojmë një vend të përhershëm pasi që edhe kjo rruga mbrapa shtëpisë së kulturës është tu rregullu dhe sigurisht që fillojnë hapësirat na lirojnë sigurisht do të gjejmë zgjidhjen edhe për taksist. Pyetje tjetër ishte edhe deponia në fshatin Drobesh. Liridon, është e vërtetë, por unë ju kisha lutë gjithë juve që edhe ju të loboni në këtë drejtim nëpër vende dhe lokalitetet ku jeni që qytetarët të jenë në menagjim mbeturinave që mos të hedhin mbeturina aty ku nuk është e parapamë, për shkak se po na shkakton edhe probleme të tilla. E di që disa herë është intervenu në atë pjesë, po prap ka vazhdu avazi i vjetër kështu që na do të mundohemi prapë ta eliminojmë këtë deponi, në mënyrë që ta kthejmë në gjendje e mëparshme, po duke apelu të të gjithë qytetarët po edhe te ju asamblistët se, ndoshta edhe prej neve këtu në mesin tonë nuk është në menaxhim të drejtorive. Është mirë që të futen të gjithë në mënyrë që mos të hedhën mbeturinat aty ku nuk duhet, mbulueshmëria me kovigjenen është thujse në të gjitha fshatrat, por vetëm që përqindja e fshatarëve ose qytetarëve të atij fshatit nuk janë të përfshim me pagesa dhe nuk kanë qenë në menaxhim. Kështu që kisha apelu, edhe pse unë një ditë e pata një takim edhe me drejtorin e inspektoratit me kovigjenen edhe me policinë në mënyrë që të marrin masa në këtë drejtim dhe të ruajmë ambientin tonë.

**z. Basri Sylejmani:** Një pyetje. Në fshatin Sadovinë janë 240 shtëpi vetëm 110 paguajnë, ku me mbajt higjienën ku vetë ata nuk i shtin në procedurë paltë që janë, pa marr parasysh a jam unë a s'jam fshati Sadovinë



ne për krejt me u pagu, e atëherë nuk ka mbeturina ku mu hedhë na nuk mundemi me 110 shtëpi me ardh me ta bo pagesën edhe me qëndru kompania. Për këtë arsye po bëjë apel që gjithë mundohemi në këtë drejtim në mënyrë që të kemi ambientin tonë më të pastërt se është për të mirën tonë,

**z.Basri Aliu drejtor:** këtë informatë e shenova do e shofim se çka mundëmi me bo në këtë drejtim. Vazhdoj me pyetjet tjera cilat ishin për kryetarin u përgjigj edhe nënkryetari, se ajo shkon edhe me Zyrën e Projekteve nuk shkon me drejtorin, na jemi për me mirëmbajt, ndërsa për pajisjet e zjarrfikësve, unë mendoj se gjitha shkollat i kanë pajisjet e zjarrfikësve dhe kështu që sa kam qenë edhe drejtor i arsimit faktikisht komandanti i zjarrfikësve më ka thirr për disa shkolla që të hapet, në mënyrë që shkojmë të verifikojmë këto pajisje në mënyrë që a janë në gjendje të rregullt apo jo. Domethënë që kjo ekziston nëpër shkolla, do të verifikoj ata mendoj se në të gjitha shkollat se duhet me qenë, po që ki ndonjë informatë Remzi me naj shkollë është mirë me naj tregu dhe ne pajisimi në këtë drejtim. Se nuk kam informacion, më vjen mirë që po na njofton asamblisti se dritat po dhezën edhe ditën edhe këto informacione është mirë me na tregu se nuk mundemi m'i përcjell të gjitha dhe kështu që mënyrë mund të intervenojmë. Ky është një informacion i mirë dhe do e shofim ku është problemi. Edhe ndërkohë pasi që kam qenë drejtor i arsimit, Liridona e bëri për transportin. Transporti për Përlepnic bartën nxënësit me kombi kështu që si informacion, u mundova me dhënë përgjigje gjitha ato çka kom mujt evidentu në qoftë se ka dikush diçka tjetër, unë jam i gatshëm me u përgjigj. Pyetje drejtorit: a mundemi me bo bashkëpunim me stacionin policor ose kryesisht me komandantin e policisë brenda këtij afati deri të bëhet zgjidhja taksistëve na me i ndalu mu parku automjetet private që ata me e pas vendin e lirë aty në qoftëse mundet mu bo ne koordinim me komandantin e policisë. Kemi bisedu në këtë drejtim, domethënë e kemi pas parasysh edhe këtë. Ndërsa në Tërstenik në sa ora the që dhezën, se duhet me ditë për shkak kohës sigurisht ka qenë koha dimërorë ma herët dhe janë dhez, por tani duhet ta përmitojmë gjithsesi, Faleminderit!

**z.Valmir Sahiti:** I nderuar Ilir, faleminderit për pyetjen! E dëgjova me vëmendje shqetësimin tuaj, i cili shqetësim në kushte normale do ishte shumë korrekt dhe do ishte shumë normal, po për shkak se event ka qenë mbajtur në vllugun e pandemisë dhe kemi qenë në masa të kufizuara, atëherë jam ftuar vetëm laureatët të cilët kanë pasur t'i marrin shpërblimet edhe çmimet e caktume. Unë e vlerësoj lartë kontributin e KKF-së "Vllaznisë", KKF-së "Vitisë" dhe secilit klub në Komunën e Vitisë. Natyrisht komunave institucione komunale të sjellën ndaj tyre me respektin mirënjohjen dhe mbështetjen e klubit, natyrisht punës sonë mundë të jetë edhe ndonjë lëshim të pa qëllimshëm, po përveç teje e ftoj dhe secilin prej jush, që vërejtjet, sugjerimet dhe këshillat tua do të jenë të mirëseardhura në mënyre se s'bashku të bëjmë me të mirën e mundshme për qytetarët e Vitisë, Po ashtu edhe një kërkesë nga Taulanti rreth "Flakadanit të Karadakut". I nderum Taulant, drejtorja për kulturë rini dhe sport, me kohë i ka filluar gjitha përgatitjet për organizimin sa me të dinjitetshëm të manifestimit gjithë kombëtar "Flakadani i Karadakut". Natyrisht duke i respektuar masat fuqi të pandemisë dhe në bashkëpunim edhe me kryetarin e Komunës së Vitisë, me këshillin organizativ do t'i bëjmë të gjitha përgatitjet, në mënyrë që, "Flakadani i Karadakut" të festohet dhe eventi të organizohet në mënyrën sa me të mirë të mundshme, Faleminderit!

**z.Adnan Imeri:** Përshëndetje për të gjithë! Me qëllim që të jemi sa më të përgjegjshëm ndaj kryerjes së detyrave të punës në drejtorin inspektionit, munde ndodhë parimisht të kthehen në seancën e kaluar, ku asamblistja, Liridona Bislimi është parashtruar si kërkesë apo një pyetje. E njëjta ka kërkuar që në rrugën Sllatinë e Epërme-Dardani të vendosen policë me qëllim të ndaljes së shpejtësisë apo kufizimit të shpejtësisë në bazë të konstatimit të inspektorit të komunikacionit dhe ekspert të kësaj fushës kem dal në konstatim rruga Sllatinë e Epërme ka një gjatësi prej 3km. E njëjta rrugë është e shenjëzuar me të gjitha shenjat e komunikacionit dhe ato të cilat e kufizojnë shpejtësinë, gjithashtu e njëjta rrugë gjatë shtrirjes së saj ka të vendosur nga anën e djathtë. Do të thotë edhe trotuari gjerësi prej 2metra që nuk preferohet, do të thotë aty ku është trotuari të ketë edhe policë, por fati do të thotë që 3km e kësaj rruge në kilometrin e parë të dytë dhe të tretë kjo rrugë i ka policët, i ka tre policë, gjithashtu posedon edhe kthesa të cilat e kufizojnë dhe shpejtësinë e



lëvizjes, dhe për këtë arsye konstatimi profesionalisht të kësaj fushe është se prej momentin nuk kemi ndonjë nevojë që të vendosim ndonjë policë të shtrirë në këtë rrugë. Besojë që është një përgjigje e duhur për asamblisten Liridona Bislimi, çështje tjetër që është shtruar është nga asambleistia Majlinda që ka të bëjë me kompanitë të udhëtimit apo operator të udhëtimit të transportit publikë në drejtorin e inspektionit në muajin Janar është paraqitur një ankesë apo një kërkesë nga një UJQ vullnetare të anamoravës dhe këtë çështje jam i interesuar me shiqu se çka ka të bëjë. Të njëjtit kanë kërkuar që nga kompanitë e transportit udhëtareve të respektohet rendi i udhëtimeve. Mirëpo aty është një problematik që të operatorit ekonomik-privat drejtoria e inspektionit nuk e ka asnjë të drejtë legjitime që të ndërhyrë në rregullimin e çmimit. Ata e rregullojnë çmimin dhe neve na prezantojnë në drejtori. Gjithashtu e rregullojnë edhe rendet Uperimit it mirëpo të njëjtët çmime pa operator janë të motivuar që ti kenë publik në autobusin e tyre apo komunikuesin e tyre. Drejtoria e Inspektionit dhe inspektori i komunikacionit, menjëherë ka bërë një njoftim dhe ka kërkuar nga këta operator që të respektojnë rendin të udhëtimit dhe çmimoret e udhëtimit i kanë publike. Çdo qytetari si cili hynë në atobus, minibus apo kombibus, është i njoftum për çmimin destinacionin se ku shkon. Gjithashtu kem kërku nga ta që 'ti vazhdojmë edhe licencën, për arsye se të njëjtit kanë licenca nga ministra dhe nga komuna një kohë kanë pauzu me licenca për arsye që nuk kanë qarkullu për shkak të virusit Covid 19, dhe tash e tutje ne si drejtori jem të obliguar dhe të përkushtuar që ditëve në vazhdim të bëjmë inspektime dhe të shikojmë se si kanë vepruar këto operator. Edhe pyetja e asamblistit, Nexhat Halilit për shenjat e komunikacionit në fshatin Tërstenik, Sllatinë e Ulët dhe Sadovinë. I nderuar këshilltar Nexhat, ne e kemi kontratën për shenjzimin në rrugë të Komunës së Vitisë. Ditëve në vazhdim do të bisedoj me inspektorin e komunikacionit do të ftojme edhe ty të identifikojmë problemet dhe mungesa e shenjave, dhe me qëllim që t'i vendosim këto shenja dhe qytetarët të ndjehen të sigurt. Faleminderit!

**z. Skënderbe Hebibi:** Përshëndes të gjithë këshilltarët komunal! Rreth përgjigjes këshilltarit Ilir Zukës na kur kemi ardhur që kur kemi fillu punën se kemi probleme rreth parkingut të automjeteve rreth zyrtarëve sepse aty parkohen edhe qytetarët e ndryshëm e kemi ngrit si çështje në bordin e drejtorëve të kryetarit dhe vetëm presim miratimin për vazhdimin e projektit ,deri mbledhjen e ardhshme të kuvendit kjo do të rregullohet vetëm të vendoset një anë e caktuar aty me karta elektronike dhe shumë e thjeshtë ,prandaj besojë që kjo kërkesë e juaja të realizohet, Faleminderit, suksese!

**Kryesuesi z. Bekim Azizi:** Drejtor i inspektionit, te taksistët, me një vendim përkohshëm deri sa të bëhet një zgjidhje që e përmendi edhe drejtori, është mirë se presioni është i çdo njërit dhe një gjendje e vështirë te taksistët, nashta me vendime të përkohshme mujm me i tejkalu. Përcjelle këtë formën që e keni të parapame me ligj ose në kuvend, me vendime të përkohshme, mos mu kanë tanë kohen tu dënu prej policisë do të zgjedhim një problem deri sa të bëhet një zgjedhje e përhershme. Dhe këtë kërkesë që nuk është përfshi, që Zyra e Informimit, aktivitetet duhet t'i paraqes sidomos në data festive të gjitha. Mirëpo kësaj radhe besoj gjitha do t'i plotësojmë.

**z. Remzi Salihu:** Nuk më dha përgjigje në pyetjen, se sa është e vërtetë arritja e marrëveshjes për legalizimin e objektit të shkollës së mesme të "Kuvendit të Lezhës".

**z. Nexhat Halili:** Te nënkryetari, ku është te kostoja e rrymës për ujësjellësin, nëse është çështja e koston e rrymës shpenzimet e rrymës atëherë e lëmë një takim dhe të bëjmë përpjekje dhe një zgjidhje për ujë , dhe nëse është çështja manganit, atëherë nëse është uji jo i pijshëm atëherë pse është lëshu në fillim ujësjellësi, pse nuk është ndal deri ne fund shembull deri rregullohen këto gjana dhe të merr Hidromorva dhe të lëshohet uji i pijshëm. Te puna e trotuarit dhe ndriçimit të trotuarit e kam realizu edhe kontratën e cila është lidh. Për këtë të ndriçimit mos po bëjë diskriminim lagjet tjera 2 lagjet të kenë ndriçim dhe lagjet tjera të mos kenë ndriçim, te rruga "Ali Muhxheri" nuk besojë që është kostja e lartë është një gjatësi e shkurt nuk është gjatësi e madhe ,ajo do të kryhet shumë shpejtë edhe një kërkesë e kam prej drejtorit inspektionit çfarë mund të bëjmë të kenë një lidhje të transportit prej fshatit Tërstenik me lidhë me Ferizaj, një kërkesë një sugjerim një pyetje se ka shumë

nxënës dhe shumë studentë që qarkullojnë. Këshilltari Liridona Bislimi: atëherë faleminderit prej drejtorit Adnan Imeri për përgjigjen korrekte kjo ka qenë një kërkesë që e kanë bërë edhe gjatë mandatit të kaluar po asniher nuk kanë hasë në përgjigje ,kjo kërkesë është parapa prej banorëve aty për shkak të fëmijëve që kalojnë duke ecur rrugës për në shkollë dhe numri i madh i veturave që e kanë konsideru që ka qenë e rrezikshme, nëse ju e shihni të arsyeshme për mos mu e vendosë ose nëse ekzistojnë paraprakisht atëherë jemi në rregull kjo kërkesë me ka përcjell vazhdimisht gjatë mandatit të kalum, por edhe gjatë këtij mandati, ndërsa duhet të kthehemi te kërkesa që kemi bërë për komunitetin për politik edhe financa nënkryetar kërkesa që kemi bërë kanë qenë në atë formë që të na dërgohen me mundësia gjatë materialit paraprakisht, por edhe ne hyrje të seancës për shkak se kemi mundësi që të bëjmë një analizë dhe kërkesën nuk e kemi bërë personalisht ne emër të Liridones apo ne emër të Jakupit, por e kemi bërë ne emër të grupit të lëvizjes vetëvendosje dhe kemi shpresuar që këto do të na sjellin gjithëve. Tash nëse e bëjmë kërkesën përmes dokumenteve zyrtare, ju e dini sa është afati kohor dhe në moment nuk do të kishim pas hapësirë me realizu këtë material, njëjtë sikurse naj keni sjell tash dhe nuk kemi kohë të mjaftueshme për me bo një analizë tillë. Te çështje e tregut të gjelbër, deri tash ju po e jepni një informacion që keni probleme me prona, mirëpo këta tregtar që jetojnë aty nuk mendojnë që një problem i tillë nuk kish mujt mu zgjidh për një kohë kaq të gjatë, po flasim për periudhën 8 vjeçare, nuk është që vetëm komuna ka treg të gjelbër, kanë edhe të gjithë komunat tjera, po me plotë kuptimin e fjalës në komunat në rrethin jemi në gjendjen të themi ma të dëmshme, më të dhimbshme të mujshe për tregtarët tanë nuk besoj që kjo do të kishte qenë përgjigja konkrete nga ju duke marr parasysht që kryetari tre mandatet ka marr guximin dhe të bëjë premtime konkrete për funksionalizimin e tregut pa marr ashtu siqë e meritojnë ,dhe tek çështja e udhëtimit për nxënës në fshatin Polishtë ,unë besojë se qoftë edhe një nxënës i vetëm nëse e humb mësimin për shkak të udhëtimit është e dhimbshme, ne atje kemi dhjetë nxënës të cilët sinqerisht bëjnë apel që udhëtimin mos tia ndërpresin për shkak se ju obligohet për shkak të kushteve ekonomike të dopta pa ndërpre edhe mësimin e tyre. Faleminderit!

**z.Jakup Demiri:** Nënkyetari tha se, i keni pas 15 pyetje është e vërtet që kemi pas 15 pyetje kem pas më pak se çdo herë për shkak se drejtori i financave kryesisht pikat e pasqyrave financiare drejtori është i ri dhe e kursyem disa prej pyetjeve ,nënkyetar unë të kam kërku tjetër sen dhe ti më ke pru tjetër sen dhe ketë e din shumë mir. Ne kemi kërku një listë të kontratave njerëz që janë me shërbime të veçanta, se çdo herë që kem kërku naj kanë pru listën me emra dhe mbiemra qeto e kam kërku. Për këto duhet me diskutu se s'ka kuptim mbledhja mu mbajt nëse nuk diskuton dhe për këto, nuk kemi kërku me na pru letër për drejtorin e inspektionit për trajtimin e qenve endacak, kemi kërku diçka tjetër, dhe kur po fillon me diskutimin një herë po na u drejtohesh qysh me pas qasjen si the ti duhet mi kqyr aty pronat se si është te puna e tregut të gjelbërit ajo problematik nuk e di se si është, unë e di se çka i ke premtu edhe nuk murrët asnjë përgjigje për çështjen e faqes së komunës, e cila nuk publikon asnjëherë asnjë informatë për lëvizjen vetëvendosje në manifestime dhe aty ku i takon të ketë kujdes se edhe ne jem pjesë e këtij populli, këtij vendi.

**znj.Majlinda Shabani:** Sa i përket operatorit transportit publik linjat urbane- periferike, zotri Adnani e shpjegoj rastin se qysh ka qenë, po sa i përket lëndës e kam parë, domethanë operator është i obligum me vazhdu licencën dhe rendet e udhëtimeve konforme rregulloreve dhe ligjeve në fuqi për udhëtimin e ketij lloj transporti. Të respektohet çmimorja e shërbimeve të transportit, domethanë jemi tu ndal te kjo e dyta të respektohet çmimorja edhe në ketë rast çmimorja nuk është tu respektu. Unë e di se edhe diskutimin që e kemi pas me zonjushën ne fjalë dhe kishim dashtë me marr hapa ma konkret, për shkak se që është e papërballueshme për një familje e cila posedon dikun tre fëmijë dhe me pas ni kosto kaq të lartë për me pagu udhëtimin. Faleminderit!

**z.Durim Sylejmani:** Një kundër përgjigje për kolegun këshilltar, kur tha te deponia e bërlllogut në Vërban. Ky bashkë me kryetarin, se ajo deponi nuk është sot as dje, është që 8vite. Ky bashkë me kryetarin ka ardh aty,

ju ka premtu. Tash mos u mundoni me i thanë drejtorit hiqe bërllugun, po ndërtonte edhe parkun ashtu siç keni premtu.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Detyra e këshilltarit është tjetër, detyra e drejtorit është tjetër. Nuk mujm për punën e sotit këshilltari me pas detyrën e drejtorit. Një, dhe pjesa tjetër, ajo çka është diskutu në seancën e kalume që është dikskutu zyrtarisht është e shkruame në procesverbal çka flitet në tavolina nuk janë pjesë të procesverbalit, takimit, mbledhjes. Çka janë diskutu zyrtarisht janë në procesverbal.

**z.Ali Bajrami:** Unë dashta vetëm një falënderim drejtorëve për përgjigjet në mënyre profesionale për të gjitha pyetjet. Problematiken e deponisë “Te Sokolt” e njof, e di se kam qenë prezent aty. Deponia që është kriju tash, se ajo hapësirë kontrastu para dy vjetve atë deponi e kanë kriju pikërisht “Sokolt”, jo kërkush tjetër edhe përgjegjësi kryesore për atë deponi e bartin ata vetë. Unë kam qenë kam bisedu me ta pikërisht sa i përket kësaj çështje, sa herë të shkoj aty shoh njerëz të asaj lagje. Prandaj, nëse ata nuk janë të interesum edhe komuna e ka të vështirë me pastru atë pjesë, se pikërisht janë ata që hedhin.

**z.Remzi Salihu:** Një debat me kolegun tim: tha se gjithçka që thuhet në kuvend edhe merret parasysht. Unë këtu me fjalën e kryetarit nuk shoh kerkun që është përmend se e ki kërcënu drejtorin, kërkun se kam gjet në procesverbal. Që kam debatu është diçka tjetër.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunes:** Ndoshta nuk kisha me marr fjalën me të drejtën, po megjithatë vetë replikat e këshilltarëve të kuvendit detyrohem në disa raste. Në këtë rast për tregun e gjelbër. Jakupi, Liridona serish sjellin të njëjtin, nuk e di çfarë përgjigje këta kërkojnë. Duhet me shtremu përgjigjen a duhet me thanë të saktë? Në rast se diçka prej ktuhit që e kam thënë në foltore, unë e mbaj përgjegjësinë për atë edhe rreth pronës edhe të drejtës të kandidatit për kryetar të komunës me dal me bashkëbisedu. E tani masi ju dhemb që sja kem dhanë votën, është çështje tjetër, ato smujm mi bisedu. Këtu bëjë përpjekje mu sjell si nënkryetar komune dhe përgjigje me ti dhanë. Atë që ta kam thënë është e vërtetë se, nuk e kam ndëgju se nuk i iki të vërtetës, por nuk e kam ndëgju po ta them me sinqeritetin më të madh, se nuk i bëhem servil kërkuj. Këto duhet me pas të kjart. Tjetër, çështje është kujt i jep llogari nuk e kam ndëgju dhe ne rast se e ki marr se kur të bëjë pot maj ligjëratë jo se as unë nuk kamë peshore të matjes të dinjitetit as dijës kërkujt ski as ti, dhe nis prej vetit dhe ta kam thanë këtë formë. Në këtë formë edhe Jakupi ka reagu po na mëson qysh mu sjell, nuk po të msoj po ka msu ligji urdhëro kqyre ligjin çka thotë për këshilltarin komunal dhe cila është etika e këshilltarit e kuvendit komunal dhe si duhet të sillemi dhe ne rast se nënkryetari i komunës bënë thirrje për respektim të normave ligjore, ligje të cilat i ka pru Kuvendi i Republikës së Kosovës, unë konsideroj se është në konform detyrës. Në rast se ju dini diçka jashtë kësaj që muj mos me ditë, por kam thënë dhe po e them sërish, se vetëm të sillemi konform detyrave për çka e keni marr votën dhe e keni dhënë betimin. Remzi, mem falë nuk e kam bërë qëllimisht. Marrëveshjen të cilën e kanë lidhë është e vërtet se është një iniciativë e drejtorit/menaxherit dhe që po bëjnë përpjekje me rregullu atë është edhe një marrëveshje tjetër e cila nëse arrijmë kryeministri që ka qenë e ka vizitu Komunën e Vitisë e ka përkrah si objekt edhe bëhet si një okupator biznesi dhe të rregullohen me të vërtet ato punë praktike të cilët i kanë nxënësit. Ne po bëjmë përpjekje t’i realizojmë në rast se arrijmë, besoj që është e mirë, tash te çështja e informimit a është dashtë me ju informu këtu, po nganjëherë këtu ju thash edhe me herët, të gjitha këto të cilat nuk po varen drejtpërdrejt prej buxhetit të komunës, mund të dështojnë, dhe këtë dështim unë kurr nuk kam qef me ardh me ju njoftu dhe masanej me gjetë shkaktarin se qysh ta realizojmë. Veç në të realizohet, nuk ka problem. Unë besoj, edhe ti dot jesh i kënaqur edhe ne. Nexhat, ajo kushton nashta pak po buxheti, ti je ekonomist si parashihet qekaq kanë mu investu në Tërstenik, sa ka dal, a ka dal një rrugë a gjysmë rruge po me gjithat duhet me ditë se, tash e tutje ti si këshilltar i kuvendit komunal je këshilltar i kuvendit komunal të Komunës së Vitisë. Është edhe Tërsteniki, edhe Remniki, edhe tash nëse nalemi 27 këshilltar i paraqesin vetëm problemet e lokaliteteve të vetë, në momentin kur e aprovojmë buxhetin, i përcaktojmë edhe projektet ku kem me punu dhe vazhdojmë. Dëshira jonë është besoj që edhe e juaja, me i pas 10milion buxhet Komuna e Vitisë të investimve kapitale besoj se këtë muhabet që po e bëjmë e kishim



kry. Unë kam vizitu edhe për 8 vite është një prej lokaliteteve që e dinë edhe ti, ta përsëris, është një prej lokaliteteve që ka përfitu më së shumti.

**z.Adnan Imeri, drejtor:** Sa e dëgjova Majlinden se çfarë ke bërë me përfaqësuesin, nuk di qysh e ki siguru ti bisedën tem, që inqezimi në mënyre të pa autorizuar është vepër penale edhe pikërisht ja kam cek edhe asaj vajzës, ajo është e re i kam thënë të kish kujdes, se mundesh me pas gabim. Unë me titull jam magjister i shkencave juridike penale, çdo fjalë që e thamë e parashoh saktë se ku me qon. Për këtë arsye që jam interesu për atë çështje do të interesohem prapë, edhe rastet e familjeve të cilët i kanë tre studenta, katër studenta për mu është shumë me rëndësi që ata në mënyra të ndryshme që ti hiqen shpenzimet, ndërsa për një rast të veçantë na nuk mujm me intervenu te operatori ekonomik që me i liru çmimet.

Çështja e rregullimit transportit mes komunave. Përveq pëlqimeve nga ministria, domethënë bëhet edhe memorandumet bashkëpunimeve në mesë dy komunave. Është një i tillë i rregullum, do të thotë në Sllatinë, Dardani, Ferizaj është një operator. Besoj që edhe për këtë linjë ka mu bo një zgjidhje.

**z.Musli Neziri:** Një vërejtje dashta drejtorit të inspektionit. Tani më jeni kryesues. Asnjëherë më mos dedikohet me Bekim. Domethënë Bekë je në kafe, ndërsa këtu je kryesues. Prandaj në të ka kujdes si magjister që është.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pika e parë jashtë rendit ditës është dhënë sot mundësia e mjaftueshme, besoj që kontribut të tillë, atëherë e shohim vlerën tonë si këshilltar, nëse e japim nëpër pika të rendit të ditës, aty shifet profesionalizmi juaj. Pikat e rendit të ditës. Aty shifen problemet e qytetarëve se sa po punojmë edhe sa po japim kontribut, që këto pika të rendit ditës të shkojnë mirë të rregullohen, sepse jashtë rendit ditës është e lehtë, sepse 1 muaj ka mundësi mblidhen shumë pika t'i diskutojmë. Faleminderit shumë! Për seancën e sotme kemi parapa, domethënë prej Komunitetit për Politikë dhe Financave, këtë rënditje.

## R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja a parë e rregullt e KK-së.
  2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2021.
  3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores me Nr.01-110/05-731, të datës 24.09.2021 për taksa, ngarkesa dhe gjoba.
  4. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e iniciativës së kryetarit për ndryshim dhe plotësimin e statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011.
  5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e komisionit për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011.
  6. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e Propozim Vendimit për formimin e Komisionit për procedurat e mëtutjeshme të dhënies me qira të vendgjuetisë në territorin e Komunës së Vitisë.
  7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Barazi Gjinore.
  8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Arsim, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë.
  9. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2022.
  10. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e Propozim Vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2022.
- Për rendin e ditës kisha hapë diskutim nëse ka diçka.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Këshilltar të respektuar, unë këtu para jush kamë sjell edhe piken e njëmbëdhjetë në rast se miratimin e juaj me lejoni ,këshilli I fshatit në Gërmovë ka bërë një kërkesë që nga 04.06.2021 megjithatë shumica prej juve e dini momentin kur shpallen zgjedhjet kuvendit dhe ekzekutives gjysma e kompetencave, në mesin e saj edhe kjo të cilët nuk kenë pas të drejt me debatu sërish tash këshilli i



iniciatorëve prej ati lokaliteti më ka drejtu një kërkesë të tillë për ndarjen e lokacionit për vendosjen e bustit martirit Milaim Tahirit nga fshati Gërmovë, prandaj në rast se e kemi edhe miratimin nga ana e juaj ju propozoj që ta futni në rend të ditës si pikë njëmbëdhjetë të rendit ditës. Faleminderit kryesues!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Është një pikë që ka ardh kërkesë. Atë pikë e kemi procedu në Drejtorinë e Planifikimit dhe në Drejtorinë e Kadastrit. Kemi marr përgjigje, ama ka ardhur me vonesë që nuk ka ardh në komunitet. Për të njëjtën kërkesë që e kanë bërë tashti tjetrën kërkesë e ka bërë këshilli i fshatit në muajin qershor 2021. Është një parcelë që këta e kanë parapa që mund të jetë për Milaim Tahirin, që vitet 89-90 është me forca serbe është propozim në rend të ditës. Materiali është i gatshëm për këtë seancë. A jeni që kjo pikë të hynë në rend të ditës? Vetëm për këtë pikë është fjala, të është në rend të ditës. Tani miratohet komplet rendi i ditës. A jeni që kjo pikë të hynë në rend të ditës? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka. A jeni që të miratohet rendi i ditës me këto njëmbëdhjetë pika që i parapamë tashti komplet? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka. Miratohet i ditës.

Pikën e parë të rendit të ditës:

## 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja a parë e rregullt të kuvendit komunal

Hapim diskutimin për këtë pik të rendi të ditës.

**z.Remzi Salihu:** Faleminderit kryesues në leximin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar pra unë te fjala e kryetarit nuk pash disa fjali që janë thënë këtu nuk e di a janë përvjedhur a janë të qëllimta apo janë të deligjuar, sepse ju të gjithë këtu të pranishmit jeni dëshmitar që ai mua më ka drejtuar thjesht se kam kërcënuar drejtorin e shkollës ku unë punoj dhe më heret e bisedum ket problem gjithqka folet në foltore që është mbrenda rregullave ligjore duhet të evidentohet në procesverbal prandaj unë pyes është bërë ndonjë lëshim, është bërë ndonjë kërcënim.

**z.Ali Bajrami:** Në diskutimin tim që e kam bërë faqen njëmbëdhjetë nuk kam thënë para, po pranë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Procesverbalin sekretaria e pregadit, Fatlum besojë nëse është bërë naj lëshim

**z.Fatlum Demiri:** Faleminderit kryesues! I nderuari Prof, duhet të bëjmë një dallim midis transkriptit dhe procesverbalit. Sekretaria e kuvendit bënë procesverbal jo transkript. Transkripti është ajo e gjithë që diskutohet, procesverbal mundohemi me i shkru thelbin e asaj çka diskutohet. E tjetra, nëse kryetari ka thënë jashtë rendit ditës që, ti e ki kërcënu drejtorin e shkollës nuk shkruhet në procesverbal, nëse ka qenë brenda rendit ditës, unë do ta dëgjojë prapë incizimin dhe nëse është ashtu, gjithsesi do ta cekim në procesverbal. Nuk është bërë me qëllim.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që të miratohet procesverbali me përmirësimet e dhëna? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Pikën e dytë të rendit të ditës:

## 2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2021

**z.Besnik Imeri:** Përshëndetje i nderuar kryesues Azizi, këshilltar të respektuar, nënkryetari Aliu, kolegë të ekzekutivit dhe të gjithë të tjerë të pranishëm! Prej sekretarisë së kuvendit jam informu që, materialin e nevojshëm e keni marr me kohë, prandaj me lejoni në pika të shkurta që para jush ti paraqesë pasqyrat financiare për periudhën janar-dhjetor 2021. Buxheti i alokuar për periudhën janar -dhjetor 2021 ka qenë 13 milion 410mi 598 euro 03 cent (13,410,598,03), të cilat rrjedhin nga fondet burimore, si grandit qeveritar me 12 milion 217 mi 542 euro, të hyrat vetanake me 1milion e 50mi 971euro 10cent dhe donacionet me 42 mij 94 euro 90 cent. Është shume e rëndësishme të ceket një sukses I madh ne inkasimin e të hyrave në nivelin me të lartë për komunën tonë të cilat janë në vlerë prej 1 milion e 153 mi e 870 euro, apo 292 mi 620 euro 98 cent mbi planifikimin e buxhetit, shprehur me përqindje 33.98% mbi planifikimin, kurse krahasuar me vitin 2020 nuk kemi krahasim me të lart për 374 mi e 466 euro e 31 cent, ndërsa ndalemi te shfrytëzimi I këtij buxheti. Sa I përket shfrytëzimit e të hyrave buxhetore, për këtë periudhë janë 12 milion 674 mi 793 euro e 83cent apo shprehur në përqindje 94.51%. Dua të ju shpjegojë në kategorinë si vijojnë: paga dhe shtesa 8 milion e 211mi e 490 euro e 80 cent, shprehur në përqindje 99.99%; mallra dhe shërbime 1milion e 674 mi 384 euro 31 cent, në përqindje 84.33%: komunalit 235 mi 920 euro e 88

cent, shprehur në përqindje 73.73%; subvencione 251 mi 200 mi euro, apo shprehur në përqindje, vetëm 59.38% investime kapitale janë 2 milion 301 mi 196 euro 83 cent apo shfrytëzimi I buxhetit të planifikuar për investime kapitale është 93.21% obligimet për vitin 2021 janë 375 mi 594 euro 92 cent të hyrat e bartura janë 682 mi e 849 euro 68 cent. Pra, prej 307 mi e 254 euro 67 cent në këtë rast vlen të ceket se shfrytëzimi racional I këtij buxheti tek investimet kapitale po e përsëris ka arritur me këtë përqindje 93.21% që është arritur mjaft krahasuar me buxhetet e komunave tjera të cilat I kam konsultu. Sa I përket prezantimit, kjo ishte në pika shumë të shkurta, pasi që pasqyra financiare I kemi në detaje. Besoj që mund t'i lexoni dhe kuptoni. Ju faleminderit për kohën për çdo pyetje apo paqartësi mos hezitoni dhe përgjigjet ose përgjigjet cilat mundem I jap tash përgjigjet të cilat nuk mundem detaje për siguri ja jap në mbledhjen e ardhshme, por dashta të ndalem te Jakupi Demiri, i cili sa i përket pyetjeve në KPF. Për këtë arsye atë ditë në KPF, në mbledhje e kam cek dy here që të mi dërgoni pyetjet me imell dhe ajo është me dokument të cilën unë e kam parasysh, ndërsa përgjigjet aty i keni marr përgjigjet për pyetjet për të cilat i keni bërë në letrat që u shpërndajten nënkryetari, ndërsa për kontratat duhet me ditë që kontratat I bën personeli dhe Drejtoria e Administratës.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Drejtori e bëri prezantimin e pasqyrave, tani hapim debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Ali Bajrami:** Para vete kemi pasqyrat financiare për periudhën janar-dhjetor 2021. Konformë dispozitave ligjore drejtori i ka sjell pasqyrat. Ajo që kisha potencu në fillim të diskutimit është shumë me rëndësi tek të hyrat janar-dhjetor 2021, tek të hyrat vetanake që kemi një rritje prej 33.98%; buxheti i alokuar dhe i shpenzuar si buxhet i alokuar 13 milion e 410 mijë euro, ndërsa të shpenzuar kemi 12 milion e 674 mijë euro. Çka vlen të ceket, nëse ndalim tek hymja, i shohim përqindjen e buxhetit të shpenzuar, tri burime, që janë grandet qeveritare, të hyrat vetanake dhe donacionet. Si gjithëherë, pagat mëditjet janë shpenzuar 99.99%; mallra dhe shërbime 84.33%; tek shpenzimet e projekteve të investimeve kapitale 93.22%. Ajo që kisha cek tek kodi shërbimet e ndryshme shëndetësore 13430, është një vlerë 244795 euro; furnizimet mjekësore 74291 euro. Po e potencoj duke u bazuar, se vitit 2021 e kemi pas vazhdimin e një viti pandemik. Krejt këto mjete janë shpenzuar për qytetarët dhe të mirën e qytetarëve, që sa me lehtë ta përballoj këtë pandemi. Tek shpenzimet e buxhetit nga Zyra e Kryetarit, drejtorive, mos me hi me e elaboru një nga një, është një buxhet i shpenzuar në mënyrë solide prej Zyrës së Kryetarit dhe pjesa dërmuese e drejtorive kanë shpenzuar buxhetin bazë asaj që e kemi votu mbi 90%; Tek rritja e të hyrave vlen të theksohet tek tatimi në pronë kemi një rritje të hyrave 108.09%; nga regjistrimi i automjeteve kemi 129.07%. Krejt këto po e potencoj se janë në mënyrë direkte që kanë ndiku në rritjen e të hyrave vetanake. Çka vlen të theksohet është vlera 168.21% nga çerdhja e fëmijëve; tek bartja e pronësisë kemi 136%. Nëse e shohim shpenzimin e buxhetit të paraqitur në mënyrë analitike. Investimet kapitale, isha ndal vetëm në dy kategori: shpenzime për meremetimin e shkollave, që janë 120 mijë euro dhe kemi gjithashtu rregullimin e fushës ndihmëse në Pozharan, që është vlera 118 mije euro. Krejt në fund, tek obligimet e papaguara dhe të hyrat e bartura deri më 31.12.2021, është një pasqyrim që do të kemi suficit për afër 300 mijë euro. Kur të marrësh e ta bëjmë kryerjen e obligimeve që janë 375594 euro dhe të hyrat e bartura 682 mijë, kemi vit suficit rreth afër 300 mijë euro, që konstatimi se komuna është në vitin 2020 me këto mjete që mundet t'i investon e t'i shfrytëzon aty ku ka nevojë. Në fund dëshiroj që të vazhdoj ky trend i mirë i punës së kësaj qeverie.

**z.Jakup Demiri:** Buxheti i vitit te kaluar ka qenë dikun 13 milion e 410 mijë euro e të shpenzuara dikun 99%. Po ndalem tek shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, i kemi 15225 euro po me duket shume e madhe kjo, sepse udhëtimet brenda vendit janë shumë. Tek telefonja fikse janë 11256 euro dhe telefonja mobile 16400 euro, e ku ti mbledhim këto dalin mbi 207500 euro, d.m.th për një vit këto janë shpenzime shumë të mdhaja e kur e dimë që shumë punë mund t'i kryejmë me mjete të internetit. Tek shpërbemet kontraktuese tjera, ne nuk e kemi listën e personave që janë punësu me shërbime të tjera. Këtë e kërkoj, sepse drejtori i mëparshëm e ka sjell listën me kontrata mbi vepër. Vitin paraprak ka qenë 100 e 8 mije euro. Nga uditori i jashtëm kishte të gjetura, 83 persona që ishin në listë me shërbime të veçanta që 49 nga këta ishin të angazhuar pa i përfill procedurat ligjore edhe si personel i madh i angazhuar, e ndërsa në vitin e kaluar kjo është rrit edhe për 74 mijë euro. Numrin e të punësuarve nuk e kemi ne, nuk e dimë, po e di që nga 100 e 8 mije euro u rrit në 182 mije euro. Jemi të sigurt se kjo ka ndodh vetëm për shkak të zgjedhjeve dhe është shndërru në votë. Kanë bë fushat me pare të tatimpaguesve. Furnizim me inventar 59 mijë 384 euro, kodi 13501. Nuk e di se ku janë bë këto furnizime. Kërkojmë një informacion për këtë. Furnizim për zyre 74 mije euro, furnizime mjekësore. Këtë po du me ditë, me pas një informacion, është kodi 13630. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve 38 mije euro. Edhe kjo po



më doket shumë. Mirëmbajtja e ndërtesave 223 mijë euro. Edhe kjo është një shumë kogjo shumë e madhe në krahasim me vitin e paraprak. Tek shpenzimet për drejtori dhe për njësit e caktuara. Tek Zyra e Kryetarit edhe tek shërbimet e tjera kontraktuese janë 40 mijë. Vetëm tek Zyra e Kryetarit, derivate të veturave 281 mije euro, nuk janë shume; botimet dhe publikimet, i kemi 7300 euro; shpenzimet për informim publik janë 8357 euro; administrata dhe personeli shërbimet kontraktuese janë dikun 9500 euro, buxhet dhe financa shërbimet kontraktuese dhe pajisje tjera 25 mijë e 560 euro, dhe pajisje speciale mjekësore që janë. Cilat janë këto pajisje speciale mjekësore? Tek shërbimet publike, kodi 13509 pajisje tjera janë 80 mijë euro. Një informatë për këtë. Drejtorja për Arsim dhe Shkencë, shërbime kontraktuese tjera 41 mije është kodi 13560. Furnizim me pije dhe ushqim janë 12768 euro. Tek krahasimi i të hyrave dhe donacioni për periudhën janar-dhjetor 2021 me të njëjtën periudhë të vitit 2020. Të hyrat nga donatore për vitin 2021 i kemi pas zero, zero po duket, ndërsa në 2020 kane qenë 16 mije e 80 euro. Pse ishin të hyrat nga donatoret zero zero në vitin 2021. Faqe 27 i kemi krahasimet siç i potencova më lartë.

**z.Taulant Haxhiu:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Unë tek pasqyrat, tek të gjitha njësitë buxhetore i kanë shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit janë 15 mijë e 252 euro. 5 mijë euro është shpenzu më shumë se vitin 2020. Ku janë disloku këto shpenzime. Kemi shpenzimet e telefonisë mobile, kemi 2000 euro më shume se vitin 2020. Është mirë një sqarim, pse kjo rritje. Pajisje të tjera kemi 114 mijë, kodi 13509 vlera e lart kjo në vitin 2020 kemi pas 7000 euro më pak e tash e kemi vlerën më të madhe. Mirëmbajtja e ndërtesave. Çka përfshihet në këtë 75 mijë euro. Kemi mirëmbajtje të ndërtesave më shumë se vitin e kaluar. Çfarë furnizime janë be, kodi 14020. Kemi tek kodi 470, realizimi i subvencioneve. Vitin 2020 kemi pas të realizueshme 99.62, kurse në vitit 2021 kemi vete 59.35%. Janë realizu 40% me pak se ne vitin 2020. Planifikimi urban në vitin 2020 është realizu 99.77% kurse në vitin 2021 kemi një realizim 58.67% dhe këtu kemi dikun një regres 41% me pak të realizuara. Vërejte për disa planifikime, ose nuk është planifiku mirë ose nuk është realizu targeti.

**znj.Liridona Bislimi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në këto pasqyra kemi te shpenzimet publike, duke analizuar raportin e viti paraprak, konsideroj që në fillim nuk është i plotë, sepse nëse i shohim pasqyrat e buxhtit dhe realizimin e ti, sidomos në realizimin e projekteve kapitale, nuk ka dokumente shtesë që do të na sqarojnë secilën zë buxhetor lidhur me shpenzimet. Po ashtu kemi mungesë të informacioneve sa i përket të angazhuarve me kontratë mbi vepër, e ku vitin e kaluar ka qenë një vit elektorale. Po ashtu kur shikon pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit për periudhën në fjalë për të gjitha njësitë buxhetore, e posaçërisht për disa vija buxhetore, vëren një shpenzim në shumë të madhe të parasë publike. Vija buxhetore e shpenzimit në udhëtime brenda vendit me vlerë prej 15 mijë euro, shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendi 5000 euro, dreka zyrtare 15 mije euro, furnizim me ushqim dhe pije 14 mijë euro. Shpenzimet e telefonisë fikse mbi 11 mijë euro dhe shpenzimet e telefonisë mobile mbi 16 mijë euro. Këto të gjitha janë shpenzime lluksi. Si shpenzim tjetër interesant që hasim tek drejtorit dhe Zyra e Kryetarit është vija buxhetore, shërbime kontraktuese tjera, që kapin vlerën mbi 40 mijë euro e të cilat po dijet që bëhet fjalë për punëtorë mbi kontratë, mbi vepër, e që në këtë vij buxhetore ne vitet paraprake auditori i jashtëm kishte cekur të gjetura që, në komunën tonë ishin angazhuar numër i madh i punëtorëve me marrëveshje të veçanta, duke shkelur udhëzimin administrativ për rekrutim. Tek vendimet e gjykatave na intereson një sqarim se, pse po ndodhë kjo nëse komuna ka mekanizma ligjor, pse po përballmi me këto vendime. Dhe kërkoj nga ekzekutivi që, ta ndërpret këtë mënyrë të qeverisjes dhe të ju përgjigjet kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.

**znj.Arbnora Hajredini:** Përshëndetje të nderur të pranishëm! Sa i përket pasqyrave për të cilat po diskutojmë, duke pasur parasysh vitin i cili ishte shumë sfidues për qeverinë komunale, sepse këtë vit kemi, sepse kemi pas dy parë zgjedhje, ato komunale. E përgëzoj qeverinë komunale për menaxhimin e parasë publik dhe për shpenzimin e tyre.

**z.Nexhat Halili:** Tek projektet investime për këtë periudhë, ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik. Në kuadër të kësaj hyn edhe fshatrat Pozharan, Smirë, Kabash, Trestenik etj. Pasi që është drejtori i ri, i preferoj që në të ardhmen ta specifikoj më mirë këtë, vlera është 97493.25. Këto janë shpenzime që janë realizu, kontrata është e lidhur me 27.10.2021. Kjo ka fillu për një pjesë, po nuk janë tri tjera, sepse vlera e kontratës është 420 mije 253.13 euro. Kontratë dyvjeçare. Një pyetje, tek kontratat dyvjeçare a e kane parapa se në tregun global çmimet po ndryshojnë. Nëse e lidh një kontratë para dy vite, e çmimet ndryshojnë, çka bënë nëse terjeket operatori ekonomik. Tek asfaltimi i rrugës Sllatinë e Ulët – Viti, këtu i kemi dy kontrata. Faza e parë dhe faza e dytë. Tek faza e parë vlera e planifikuar ka qenë 285 mijë, ndërsa kontrata e cila është lidh me vlerë dikun 241

mijë e 466 euro, pagesat janë në nivel. Ku është arsyeja pse janë këto pagesa? Pse ka ardh deri këtu? Tash e kemi përsëri fazën e dytë, asfaltimin e rrugës Sllatinë e Ulët – Viti, vlera e parashikuar 2785 mijë. Tek obligimet e komunës. Kërkoj nga zyrtari i financave, pasi që obligimet e papaguara janë 375 mijë e 594.92 euro, të na sjell informatën në seancën e radhës. Një specifikë, cilës kompani i ka mbet borxh komuna? Pse ka ngec puna tek subvencionet? Ku janë 59.38%? Pse edhe këto nuk janë shku 90%.

**z.Musli Neziri:** Tek shërbimet kontraktuese tjera, shuma është 181 mijë e 17 euro. Jam i interesuar me ditë se ku janë shku këto, çka u bë me këtë shumë? Tek drejtoritë për shpenzimet vetanake secila veç e veç. Tek Drejtoria e Arsimit po me intereson furnizimi me ushqim dhe pije 12 mijë e 768 euro. Tek Drejtoria për Kulturë, Rini janë shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit 3813 euro. E kemi pas një vit pandemik, nuk e di kush ka udhëtu jashtë. Dreka zyrtare janë 7557 euro, jemi kanë në pandemi, kemi pas kufizime qysh ka ndodh kjo. Tek çerdhja po me intereson tek të hyrat vetanake, planifikim vjetor thotë 14 mijë euro, ndërsa realizim që kanë hy të hyra 30 mijë e 277 euro. Rritje d.m.th 168%, ka pas rritje në krahasim me vitin e kaluar. Këtu po du me ditë, a është mbingarku çerdhja apo si? Dhe si shqetësim që e kam të prezantimi analitik i prezantimit për periudhën janardhjetor 2021, ku flitet tek vendi i investimeve, tek ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik në fshatin Ballancë, ju referohet Balancë, d.m.th Balancë e kanë quajt ish sistemi më herët, ndërsa fshati Ballancë thirret Ballancë. Problemi është edhe tek shenja e komunikacionit, që janë vendos më herët, e kanë qit po me të njëjtin termë Balancë, e mos me ju referu ma kështu.

**znj.Zyrafete Rama:** Unë kam një pyetje për shpenzimet e përgjithshme për mirëmbajtjen e shkollave. Mu po më shqetëson kjo shifër 300 euro vetëm për mirëmbajtje për një vit, a është fjala për një shkollë apo për të gjitha shkollat.

**z.Durim Sylejmani:** Për dallim nga kolegët e mi, unë nuk kam fare konsideratë që është drejtori i ri, sepse drejtori i ri i ka dokumentacionet në dispozicion. I kam dy pyetje: tek mirëmbajtjet rutinore është 22 mijë e 397 euro. Çka nënkuptoni me këtë mirëmbajtje rutinore? Dhe tek mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve me vlerë 6 mijë 875 euro. Ndërkohë që në sallën e kuvendit i kemi dy pajisje që shërbejnë për ngrohjen e ambientit e të cilat nuk funksionojnë.

**z.Besnik Imeri, drejtor i financave:** Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Shumica e pyetjeve që i patët i murrët përgjigjet nga nënkryetari. Po filloj nga udhëtimet, drekat. Kryesisht janë nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë, Sportit, sepse kanë udhëtime me asamblatë e ndryshëm dhe mysafirët që vijnë këtu për festa të ndryshme. Përgjigjet më të sakta ju jap në mbledhjen e ardhshme ose ju dërgoj në e-mail.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Udhëtimet brenda vendi, shuma 15 mijë euro. Në këtë kategori hyn edhe personat me aftësi të kufizuar të cilëve ju kryhen shërbime brenda territorit të Kosovës. Për këtë është kjo shumë më e lartë se vitin e kaluar. Telefonat fiks dhe mobil, 27 mijë euro. Këtu duhet ta dimë se bien edhe të shkollës dhe të gjitha institucioneve. Kjo është shuma. Për çdo dyshim që e keni, mund të bëni pyetje. Çështja tek shëndetësia 13 mijë e 306. Do ta shikoj edhe unë këtë, sepse nuk po e di në seancën tjetër ju sjelli. Tek mirëmbajtja e ndërtesave 75 mijë euro diferenca prej vitit të kaluar edhe janë rrit hapësirat e mirëmbajtjes ndoshta edhe punëtorët e kanë pagën me te madhe nuk po e di. Subvencione, rregullisht jemi kritikuar i keni hargju qind përqind, e këtë vit zgjedhor vendosem me i hargju 59%. Planifikimi urban 40%. Me siguri janë tek taksat që janë parapa. Udhëtime jashtë vendi 3000 euro. Muj me sjell se kush ka udhëtu. Dreka zyrtare 8000 me pak nuk të kokan kanë kurrë, 300 euro për krejt shkollat, nëse është, është shumë e vogël. Ka mu interesu për këtë. Durimi i ngriti dy çështje. Do t'i shikojmë edhe të ju sjellim informata më të sakta.

**z.Taulant Haxhiu:** Qeto 5000 euro vlera me e madhe ma dhavë një sqarim, po jo përgjigje si e kërkova unë. 75 mijë euro ke vlera me e lart e mirëmbajtjes. Këtë e kam pa në pasqyra, e kam krahasu. Mu dukë kjo shumë e madhe. Du përgjigje pse u rrit kjo vlerë. Tek kodi 13509, pajisje 114 mijë euro: çka nënkupton kjo pajisje 7000 euro është me e lart se vitin 2020.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Saktësisht ke me marr edhe çështje e diferencës për këtë, sepse tani për tani nuk po e di, e marr kontratën edhe e shikoj e të njoftoj. Edhe kërkesën e dytë ke me marr informatën.

**z.Taulant Haxhiu:** Shumën prej 114 mijë euro e kërkoj për seancën tjetër të vjen e saktë se ka janë shku këto para.

**z.Nexhat Halili:** Ndërtimi i trotuarit 97 mijë. Është e vërtetë që thash është dyvjeçar. Është lidh kjo kontratë në fund të vitit, mirëpo në pasqyrat financiare në vitin 2019 figuron Tresteniku, merrne shikone. Tek rruga Viti-



Sllatinë e Ulët më dhavë përgjigje për fazën e dytë. Nuk më dhavë përgjigje për fazën e parë, asfaltimi i rrugës Viti-Sllatinë e Ulët. Merre këqyre paramasën, parallogarinë, nuk figuron kerkun asfaltimi.

**z.Musli Neziri:** Nënkrjetar, nuk e di a harrove tek çerdhja tek të hyrat vetanake, ishte një diferencë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Musli sigurish është rrit numri i fëmijëve.

**z.Ali Bajrami:** Tek krahasimi i buxhetit me vitin 2020, nëse e kame në vëmendje mirë, buxheti ne 2020 dhe 2021 dallon, sepse është më i madh për 500 mijë euro. Asnjë buxhet nuk është identik me vitin paraprak, prandaj ndryshojnë edhe shifrat e shpenzimeve. Ajo që për mu është rregullar krejt këto shpenzime që janë bë janë bë ne kuadër te buxhetit, që ne si kuvend komunal e kemi votu ne vitin 2020 për shpenzime buxhetore në vitin 2021. Nëse kishte tejkalime e shkelje, do të kishte reagime nga ministrinë e linjës.

**z.Sejdi Emini:** Tek pagesat për vendime gjyqësore është shuma 892 mije 822 euro. Ne e dimë që, punëtorët e arsimit në tersi kanë bë padi në gjykata dhe secili nga këta e fiton lenden sigurish, që buxheti shpërndahet nëpër drejtori. Tash përmbaruesi nuk ta zgjedh vendi, ai ku të gjanë ti merr. Mu po me intereson me ditë sa punëtor deri tani e kane fitu lenden edhe sa janë në procedurë që me i fitu, edhe sa pare ka me i pagu komuna në gjykata për këta punëtorë.

**z.Jakup Demiri:** Drejtori i financave nuk na dha përgjigje, po ne rregull. Po vetëm po du me ditë listën me kontrata të veçanta, me emra e mbiemra. A naj sjell në muajin a ardhshëm, sepse gjithherë naj ka sjell drejtori i mëhershëm.

**z.Basri Aliu drejtor:** Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Tek mirëmbajtja e ndërtesave, kuptohet se këtu hynë punëtorë që janë marr përmes prokurimit, që e bëjnë pastrimin në shëndetësi dhe në objekte tjera institucionale. Shuma që është rrit me siguri që edhe shërbime, janë më të mëdhaja.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë pikë të rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

## **2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores me Nr.01-110/05-731, të datës 24.09.2021 për taksa, ngarkesa dhe gjoba**

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Rregullorja ne fjalë është rregullore që miratohet me miratimin e buxhetit. Kjo rregullore është kthy nga MAPL-ja që nuk ka pas përputhshmëri me disa dispozita ligjore. Edhe tek kjo propozim rregullore që e keni para vete, edhe këtu duhet me bë një përmirësim. Tek neni 5 i kësaj propozim rregullore këtu duhet të ndryshohet dhe te jet çmimi nga 4 euro ne 5 euro. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, për miratim e qes në votim me votat e të gjithëve. Miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pike të katërt kemi:

## **4. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e iniciativës së kryetarit për ndryshim dhe plotësimin e statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011**

**z.Hasan Aliu nënkryetari i komunës:** Materialin e keni marr me kohë, kryetari i komunës e ka pa të arsyeshme që, duhet me i hy ndryshim plotësim të statutit, dhe e ka sjell iniciativën që t'i japim vizë për hapa te mëtutjeshme.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Ali Bajrami:** Këtë iniciativë për ndryshim plotësim të statutit, ne si grup parlamentar do ta mbështesim dhe do të jemi pro këtij

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Pasi që nuk ka diskutime të tjera, e qes në votim për miratim. Me ngritje dore, me 14 vota pro, kundër asnjë, e 6 abstenime, kalon kjo pika e rendit të ditës.

Si pikë të pestë kemi:

## **5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e komisionit për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011**

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Në kuadër të ndryshimit të statutet duhet ta themelojmë edhe komisioni për ndryshim plotësimi. Kërkoj nga tri partitë politike ta propozojnë nga një anëtar në këtë komision.

**z.Ali Bajrami:** Nga LDK-ja propozojmë, Sokol Hysenin.

znj.Liridona Bislimi: Nga LVV e propozojmë, Durim Sylejmani.

z.Taulant Haxhiu: Nga PDK-ja propozojmë, Zyrafete Rama.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Nga ekzekutivi janë të propozuar Albulena Haxhiu, Arian Alidema, Fatlum Demiri dhe një do ta propozojmë nga shoqëria civile. A jeni për miratimin e këtij propozimi me ngritje dore. Me votat e të gjithëve u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

#### **6. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e Propozim Vendimit për formimin e Komisionit për procedurat e mëtutjeshme të dhënies me qira të vendgjuetisë në territorin e Komunës së Vitisë**

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** E dimë që mandatin e kaluar e kemi pas këtë komision por tani me ndryshim të legjislacionit duhet të ndryshohet edhe ky komision.

**z.Naim Pira drejtor:** Faleminderit kryesues, më lejoni të ju përshëndes të gjithëve të pranishmeve dhe të ju uroj punë të mbarë. Ky është një propozim vendim për themelimin e komisioni për procedurat e mëtutjeshme për dhënien me qira të vendgjuetisë. E kemi pas këtë komision, po për shkak të ndërrimit të legjislaturës duhet ta sjellim prapë këtë propozim vendim. Ne nga ekzekutivi propozojmë Kemajl Frangun, i cili vjen nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Burim Sadikun, i cili është nga ekzekutivi, dhe ju mbetet juve t'i propozoni dy anëtarë nga kuvendi komunal.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Kërkoj nda dy partitë e mëdhaja t'i propozoj nga një anëtar.

**z.Illir Zuka:** Nga LDK-ja e propozoj, Ekrem Ymerin.

znj.Liridona Bislimi: Nga LVV-ja e propozojmë, Remzi Salihun.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Kërkoj miratimin e komisionit me ngritje dore. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës e kemi:

#### **7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e për Liritë te drejtat e Njeriut dhe për Barazi Gjinore**

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Jemi konsultu me nënkryetari dhe shefin e GP-së së LVV-së, që të gjitha grupet të kenë nga një anëtar në secilin komitet. Në këtë seancë i kemi dy komitete për t'i themeluar. Edhe ne seancën tjetër vazhdojmë me themelimin e komiteteve tjera.

**z.Ali Bajrami:** Nga LDK-ja propozojmë Arbnora Haradini Elezi.

znj. Liridona Bislimi: Nga LVV-ja propozojmë, Lindita Demelezi.

z.Taulant Haxhiu: Nga PDK-ja do të kemi Veton Ramadani.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Edhe dy anëtar do të plotësohen të cilët do të jen jashtë kuvendit, qes në votim për miratim nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë.

Si pikë të tetë të rendit të ditës e kemi:

#### **8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Arsim, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë**

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Në disa komitete, tu i pas parasysh numrin e këshilltarëve, nuk ka mundësi në çdo komitet me qenë nga një prej partive, po në disa prej komiteteve do të jet nga dy prej partive, që do t'i kombinojmë. Pse me një komitet p.sh.: PDK-ja nuk ka mundësi me pas anëtar, sepse nuk na përfshinë numri i këshilltarëve. E për këtë arsye do të kombinomi. Te ky komitet kërkoj propozimet. Këtu kemi parapa që, LDK-ja t'i ketë dy anëtarë e LVV-ja e PDK-ja nga një anëtar.

znj.Arbnora Hajredini: Nga LDK-ja e propozojmë Ali Bajramin dhe Sokol Hysenin.

**znj.Liridona Bislimi:** Nga LVV-ja propozojmë, Majlinda Shabanin.

**z.Taulant Hoxha:** Nga PDK-ja propozoj, Musli Nezirin.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Edhe një anëtar na jet nga jashtë kuvendit. Qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të nënë të rendit të ditës e kemi:

### **9. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2022**

**z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës:** Bënë prezantimin e kësaj pike të rendit të ditës.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Hapi debat për këtë pik të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendi të ditës.

Si pikë të dhjetë të rendit të ditës e kemi:

### **10. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e Propozim Vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2022**

**z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës:** Duke pas parasysh raporti e përformancës, ku e kemi si kusht që, në muajin dhjetor në kuvend me kalu lista e pronave, që mendohet me i dhënë në shfrytëzim. Pasi që kemi pas zgjedhje vitin e kaluar, MAPL-ja e ka pas parasysh dhe të gjithë kryetarëve të komunave ju ka dërgu shkresë, e ku e ka shty afatin deri me 31 Mars, që të miratohet kjo listë. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj. Sot ka ardh edhe një kërkesë nga fshati Kabash, e si pronë mund ta shtim në këtë regjistër. Ata kërkojnë zgjerimin e varrezave, e me shti në këtë regjistër si pronë edhe me i shiku hapat e mëtutjeshëm.

**z.Ramadan Deliu:** Tek kjo prona në Kabash, bëhet fjalë vetëm me e zgjeru aty tek varrezat.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Hapi debat për këtë pikë.

**z.Sejdi Emini:** Kur jemi tek pronat komunal, muj me thanë që, Komuna e Vitisë është mjaft e varur sa i përket pronave që janë një kapital në veti dhe një vlerë që, ndoshta na ka kushtu që nuk i kemi ruajt e na kushton edhe më shume nëse nuk i ruajmë këto që i kemi. Këtu tek disa prona në Gushicë, po shoh që janë dikun 9 parcela ne disa fshatra, mirëpo nuk e di sa na lejohet me ligj, që këto prona me i shfrytëzu në interes të qytetarit, komunës. Ndoshta ish kanë mirë me e analizu, e këto prona me ju dhënë jo afat shkurta po afat gjata. Pse mos me ju dhanë më afatgjatë, e ku disa prona me ju dhanë investitorëve të huaj për 20-30 vite.

**z.Taulant Haxhiu:** Nënkyetar, tek paluejtshmëria në Budrikë të Epërme. Nëse është fjala për tek zona industriale, ne e dimë se, kemi shume biznese të Vitisë, që janë të interesuar që këto shumë shpejt ta kenë një plan dhe të vendosen këtu, po duhet me ardh një vendim që të konkurrojmë dhe ta zhvillojmë atë pjesë. Propozoj që këtë vit të konkurrojnë bizneset e të vendosen aty.

**z.Durim Sylejmani:** Tek lista e veçantë e pronave, është numri rendor 4, tek objekti i QKMF-se në zonën kadastrale në Viti. A ka mundësi me ditë, nga buron kjo e drejtë me ja dhanë këtë një operatori privat, barnatore brenda objektit të QKMF-së. Unë mendoj që është diskriminim ndaj barnatoreve tjera që operojnë në Komunën e Vitisë.

**z.Nexhat Halili:** Unë kame një pyetje tek kjo pika 2. Kjo është tokë pyjore, e prej tokës pyjore parashihet të shndërrohet në tokë bujqësore.

**z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës:** Po filloj nga Sejda. Edhe unë jam ithtar i asaj, edhe kam kërku krejt pronat me i ditë cilat janë ne dispozicion për shfrytëzim dhe me i terjek investitorët. Çështja tek zona industriale, ka qenë investim i ministrisë, e këtë vit besoj që do ta bëjnë thirrjen e pranimit teknik, e tani do ta bëjmë thirrjen për aplikuesit që dojnë me apliku. Vullneti im është, që këtë vit me i vendos aty. Durim, sipas

informacioneve që i kam, aty tek QKMF-ja po i përfundojka kontrata këtë vit, e nuk do mund të jete i privilegjuar, e pikërisht për këtë është bërë kjo, që të del në ankand publik, e nuk dijet se cili e fiton atë.

**z.Taulant Haxhiu:** Nënkrjetar, tek kjo sipërfaqja në Budrikë, unë po e shof që prona parashihet të jepet ne shfrytëzim afatshkurt. Kjo është kaq e madhe, aty park i biznesit. Po të parashihet në shfrytëzim afatshkurt: sa do të jete ky afat shkurt, 40-30 apo sa? Sepse bizneset e mëdhaja nuk vjen me apliku për afatshkurt, për 15 vjet. Po me doket e palogjikshme.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Tek periudha kohore në dhënien ne shfrytëzim të pronave të paluajtshme, besoj që tu e përjashtu zonën industriale, e kisha shënu me kohë afatgjate, ndërsa të tjerat i kisha lan të hapura, sepse varet sa e kërkon investitori, ndërsa zonën industriale e kisha lanë afatgjate.

**z.Remzi Salihu:** Unë prapë po thamë, nëse e votojmë kështu siç është, ne po votojmë për shfrytëzim të qasaj prone që po e diskutojmë, ose kërkoj të ndryshohet e të plotësohet. Edhe tek zona industriale jam dakord të shkon më afatgjatë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Remzi, do ta plotësojmë këtë që e kërkoje ti dhe me përmasim do të shkon kjo.

**z.Illir Zuka:** Unë po mendoj vetëm nëse nuk jemi tu dashtë me e kuptu. Kjo është një listë që tregon se, në Komunën e Vitisë janë qeto prona të lira. Qata që kërkojnë me marr në shfrytëzim, prapë ka me ardh në kuvend propozimi, që me dhanë në shfrytëzim. Ne tani nuk jemi tu i dhënë askujt pronë.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim me ndryshim plotësimet e kërkuara nga këshilltarët dhe nënkryetari. Duhet të plotësohet me listën e veçantë. E qes në votim për miratim listën. Me një votë abstenim, të tjerat pro, miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të njëmbëdhjetë të rendit të ditës e kemi:


#### **11. Propozim vendimin për përcaktimin e lokacionit për vendosjen e bustit memorial të Milaim Tahirit në fshatin Gërmovë**

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Tu e pas parasysh që, kërkesa kuvendit ju ka procedu me 04.06.2021, po tu e ditë që 6-mujorishin e fundit të kuvendit nuk mund të jet në shfrytëzim token komunale, kjo është shtu për tani, ku është përsëri kërkesa nga këshilli iniciues, e ku ne e kemi procedu këtë kërkesë tek Drejtoria e Katastrit dhe Urbanizimit. Këta e kanë kthy përgjigjen dhe e kanë sjell propozim vendim, dhe hapi debat për këtë pikë të rendit te ditës. Qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës. Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:00 min.

**Procesmbajtësi:**

**Fatlum Demiri**



**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**

**Bekim Azizi**

